



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 25.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Malesija" për aktivitetin :"**Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-8733-121 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet ankesa e Operatorit Ekonomik "**Malësija**" e datës 25.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës**", me Nr.616 18 8733 121 Nr. Brendshëm 616 18 126 121 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së dhe Refuzimin e tenderit të pretenduesit , të 20.02.2019, dërguar me datën 21.02.2019 dhe publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 21.02.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit.*
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Malesija**" me datë 26.02.2019 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"**Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës**". Autoriteti Kontraktues, me datë 27.02.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me tenderuesin e propozuar për dhënje të kontratës, me arsyetimin se i njëjti nuk ka referenca të

ngjajshme në vlerën e kërkuar dhe se i njeiti ka konkuruar me një mostër të numrave që nuk është prodhim i tij,por është hequr nga numrat që i ka vendosur pretenduesi.

Lidhur me pretendimin e parë ju sqarojmë se është i pa bazuar,pasiqë vetëm dy referenca:njera nga Komuna e Prishtinës në vlerë prej 22.418.60 € dhe tjetra e Komunes së Fushë Kosovës në vlerë prej 37,480.00 €,e plotësojnë vlerën e kërkuar prej 50,000.00 dhe kanë të bëjnë me shërbime të ngjajshme sipas kërkesave të FDT-së.

Pretendimi tjetër lidhur me shenjën e dorëzuar si mostër ka të bëj me diçka që nuk ka qenë kerkesë e dosjes së tenderit dhe ne nuk jemi kompetent të merremi me çështjen që ju e potenconi lidhur me mënyrën e sigurimit të të njejtës.

Bazuar në faktet e paraqitura më lartë është konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar tenderin në mënyrë të ligjshme e në harmoni me kërkesat e FDT-së dhe bazuar në këtë u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit